

# MANUAL PËR RAPORTIMIN MBI EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM DHE TERRORIZMIN



**Albanian Media Institute**  
**Instituti Shqiptar i Medias**

Tiranë, 2021

## Manual për raportimin mbi ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin

Manuali u hartua nga grupi i punës: Ilda Londo, Instituti Shqiptar i Medias, Mark Marku, Universiteti i Tiranës, Erlis Çela, Universiteti Bedër, Lutfi Dervishi, Televizioni Shqiptar dhe Dorentina Hysa, aktiviste e shoqërisë civile, me ndihmesën e konsulentit ndërkombëtar Aidan White.

Copyright: © ISHM

Botues:



**Albanian Media Institute**  
**Instituti Shqiptar i Medias**

Rr. Gjin Bue Shpata, No.8, Tiranë, Albania

Tel./fax: ++ 355 4 2229800

E-mail: [info@institutemedia.org](mailto:info@institutemedia.org)

[www.institutemedia.org](http://www.institutemedia.org)



**Hedayah**

countering violent extremism

Ky botim u mundësua me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian, në kuadrin e një projekti të menaxhuar nga Qendra Ndërkombëtare për Ekselencë në Luftën ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm HEDAYAH. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësia e vetme e Institutit Shqiptar të Medias dhe jo domosdoshmërisht reflekton pikëpamjet e Bashkimit Europian.

## **Treguesi i lëndës**

1	Hyrje dhe konteksti .....	5
2	Përkufizimet e terrorizmit .....	12
3	Normat ligjore, politikat kombëtare dhe ndikimi mbi median .....	16
4	Parimet themelore të raportimit mediatik mbi terrorizmin .....	23
5	Aspekte të veçanta që duhen patur parasysh kur raportohet për terrorizmin .....	27
6	Sfida dhe probleme gjatë raportimit të drejtpërdrejtë për terrorizmin .....	35
7	Roli i mediave sociale .....	37
8	Shmangia e gjuhës së urrejtjes .....	50



# 1

## Hyrje dhe konteksti

Raportimi mbi ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin është një sfidë serioze për mediat bashkëkohore. Dhuna politike i shtrin rrënjët thellë në histori, ndërsa sot, në epokën e komunikimeve digjitale, terrorizmi është një fenomen global me ndikim të madh në jetën e individëve dhe shoqërisë.

“Incidentet” terroriste përbëjnë lajm kryesor që përhapet me shpejtësi marramendëse në rrjetet globale. Transformimet dhe risitë e sjella nga interneti e kanë diversifikuar dhe përforcuar ndikimin e mediave tradicionale. Lajmet shpërndahen në mënyrë më të shpejtë, më të qartë dhe gjithëpërfshirëse, dhe si rezultat edhe impakti dhe ndikimi i terrorizmit bëhet më i fuqishëm, dhe jehona e tij ndihet më gjatë. Në këto rrethana, misioni shoqëror i gazetarisë, roli dhe përgjegjësia e mediave luajnë një rol edhe më të rëndësishëm.

Raportimi për ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin është shumëdimensional, dhe nuk mund të kufizohemi vetëm në një diskutim rreth standardeve etike dhe profesionale të raportimit. Edhe roli që luajnë mediat duhet të shqyrtohet nga këndvështrimi i qëllimit të qartë të terroristëve - për të gjeneruar publicitet dhe propagandë për aktet e tyre të dhunshme dhe për të rritur mbështetjen për “kauzën” e tyre.

Ekstremizmi i Brigadave të Kuqe në Itali me rrëmbimin e Aldo Moros (1978); masakra palestineze dhe marrja peng e atletëve izraelitë në Olimpiadën e Mynihut (1972); Sulmi

i Al Kaedës mbi kullat binjake në New York (2001); sulmet terroriste dhe vënia e bombave në qendër të Londrës dhe Parisit (2015), dhe shumë akte të tjera terroriste, kishin për qëllim që të tërhiqnin vëmendjen e publikut në mbarë botën rreth motiveve politike që frymëzuan këto sulme.

Për këtë arsye, diskutimi rreth raportimit mediatic të terrorizmit është kompleks. Në të përfshihet përgjegjësia e medias për të raportuar të vërtetën, por kërkohet gjithashtu që të arrihet një njohje më e thellë e kontekstit, dhe veçanërisht të kuptohet se aktet e bujshme të dhunës nga ana e terroristëve janë shpesh pjesë e një plani strategjik, që synon të përdorë dhe manipulojë mbulimin mediatic.

Në mënyrë që të sigurojnë publicitet për motivet dhe narrativat e tyre, rrjetet terroriste shpesh krijojnë mediat e tyre. Për shembull, ekstremistët islamikë të lidhur me ISIS-in krijuan dhe shfrytëzuan disa organizata të fuqishme mediatike si Instituti Al-Furqan për Prodhime Mediatike (*Al-Furqan Institute for Media Production*), Fondacioni i Medias Al-I'tisam (*Al-I'tisam Media Foundation*), Qendra e Medias Alhayat (*Alhayat Media Center*), Fondacioni i Medias Ajnad (*Ajnad Media Foundation*), si dhe portale të tilla si Dabiq, Islam State News, etj.

Përveç kësaj, ata u mbështetën nga një rrjet i gjerë propaganduesish “të pavarur,” që prodhojnë dhe publikojnë përmbajtje mediatike, të marrë nga mediat tradicionale dhe digjitale, dhe që transmetohen më pas nëpërmjet mediave sociale për publikun e gjerë në nivel global ose lokal. Kështu për shembull, videot propagandistike të xhihadistit shqiptar Lavdrim Muhaxheri, që u shfaq në pamjet filmike të prerjes së kokës së një pengu, ose duke lëshuar një predhë raketë u përhapën nëpër të gjithë botën përmes kanaleve mediatike. Muhaxheri synonte të arrinte një audiencë sa më të gjerë publike, dhe duke transmetuar këto imazhe, mediat

tradicionale, me ose pa dashje, ndihmuan Shtetin Islamik në përmbushjen e qëllimit të tij: përhapjen e frikës dhe terrorit.

Për më tepër, grupet terroriste kanë kanalet e tyre mediatike përmes përdorimit të mediave sociale dhe platformave të publikimit dhe shpërndarjes së përmbajtjes. Aftësia e tyre për të publikuar dhe shpërndarë video ekzekutimi me prerje koke, qofshin ato të vërteta apo të rreme, është vetëm një nga shembujt e përdorimit të mjeteve të komunikimit masiv, dhe hap një debat të ri mbi trajtimin e kësaj lloji përmbajtjeje nga platformat e mediave në internet dhe mediat sociale, ndërsa ato përpiqen të arrijnë një ekuilibër midis informimit të publikut dhe propagandimit pa dashje të terrorizmit.

Për shembull, në Shqipëri, videot e Lavdrim Muhaxherit u transmetuan shumë herë, duke i bërë jehonë terrorizmit të tij. Dilema për raportimin e akteve të tilla nuk është se haset vetëm në Shqipëri, madje ekspozimi ndaj akteve terroriste të dhunës është bërë tashmë pjesë e një debati të gjerë ndërkombëtar në lidhje me ndikimin psikologjik në publik të dhunës në media. *“Ekspozimi ndaj përmbajtjes së dhunshme në media sjell shkatërrimin e normave dhe vlerave kulturore dhe shoqërore, si dhe nxit akte kriminale dhe sjellje të dhunshme nga ana e publikut.”* (Newburn, 2007).

Mënyra se si raportohet mbi terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm nga mediat duhet të bëhet objekt i analizave profesionale dhe vetëreflektimit brenda radhëve të gazetarisë. Në Shqipëri, mediat shpesh përqendrohen në raportimin e ngjarjeve specifike dhe nuk japin informacion mbi kontekstin për të sqaruar dhe kuptuar më mirë dukurinë e ekstremizmit apo terrorizmit.

Përveç kësaj, në një kontekst global, ekziston rreziku i identifikimit të Islamizmit me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin, çka rrezikon të çojë në paragjytime nga ana e publikut të gjerë ndaj myslimanëve.

Ndërkohë që dhuna politike mund t'i ketë rrënjët e saj në mosmarrëveshje ideologjike, fetare ose etnike, reduktimi i fenomenit të terrorizmit vetëm në ekstremizmin islamik, mund të legjitimojë diskriminimin dhe paragjykimin ndaj myslimanëve. Në shoqërinë multifetare të Shqipërisë kjo mund të sjellë intolerancë dhe rrënimin e bashkëjetesës fetare.

Vëmendja e mediave shqiptare ndaj terrorizmit u rrit pas daljes në skenë së Shtetit Islamik dhe përfshirjes së qytetarëve nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut në fushatën e dhunës të ISIS. Përpara kësaj, terrorizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm raportohej në mediat shqiptare kryesisht në rubrikën e lajmeve nga bota, përmes lajmeve të përkthyer nga mediat ndërkombëtare. Pamundësia e mediave shqiptare për të dërguar gazetarët në zonat e konfliktit nëpër botë, ose në vendet ku janë kryer akte terroriste, i ka privuar prej kohësh organet mediatike në vend nga ky lloj raportimi, dhe nuk kanë patur mundësi që të fitojnë përvojë në këtë fushë.

Burime nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, që u cituan nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarëve Investigativë (BIRN), vunë në dukje se *“Me shfaqjen e Shtetit Islamik, më shumë se 100 shqiptarë u bënë pjesë e grupeve xhihadiste në Siri dhe Irak, duke përfshirë edhe 13 gra dhe 31 fëmijë.”* Niveli i përfshirjes së luftëtarëve nga Shqipëria tërhoqi vëmendjen e mediave, dhe shumë gazetarë u përqendruan në identifikimin e njerëzve që punonin për ISIS.

Ndonëse pati një rritje të nivelit të ndërgjegjësimit dhe mbulimit mediatik, cilësia e raportimit nuk u përmirësua, dhe nuk pati mbështetje apo burime financiare shtesë për raportimin e terrorizmit, me përjashtime të rralla. Konkretisht, disa nga çështjet kryesore në lidhje me raportimin e terrorizmit mbeten pa përgjigje në media: kush ose cilat janë shtysat apo arsyet për rekrutimin e luftëtarëve të ISIS? Cilat grupe ekstremiste u ofrojnë të rinjve “përmëshjen e një sërë



nevojash themelore shoqërore, ekonomike dhe psikologjike,” dhe cilët prej tyre indoktrinojnë ideologjikisht këta të rinj në mbështetje të ekstremizmit totalitar, etnik ose fetar?

Në nëntor 2016, në kuadër të një operacioni rajonal antiterror në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, nga strukturat e specializuara të policisë në luftën kundër terrorizmit, u ndaluan katër shtetas shqiptarë, duke përfshirë dy hoxxhallarë, si dhe u arrestuan 16 persona të tjerë, duke përfshirë pesë shtetas të huaj dhe 11 shqiptarë. Këta persona u arrestuan pasi *“ata dyshoheshin se në bashkëpunim me njëri-tjetrin dhe shtetas të tjerë jashtë vendit përhapnin dhe nxisnin frymën e urrejtjes, rekrutonin persona për të shkuar në Siri që të bëheshin pjesë e organizatës terroriste ISIS, dhe kanë mbështetur këtë organizatë terroriste me logjistikë dhe fonde, dhe kishin udhëtuar në zonat e konfliktit në vendet e Lindjes së Mesme.”*

Arrestimet zbuluan ekzistencën e rrjeteve të rekrutimit, por pavarësisht kësaj, media nuk arriti të nxirrte në publik informacione shtesë në lidhje me shtrirjen dhe pasojat e aktivitetit të këtij rrjeti, metodat e tyre të rekrutimit, ose numrin e personave të përfshirë në këto aktivitete.

Në përgjithësi, gjatë këtyre 20 viteve të fundit media shqiptare nuk ka patur një bazë të shëndoshë dhe nuk ka fituar përvojë në raportimin e ngjarjeve apo situatës globale në lidhje me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin. Kjo mund të justifikohet dhe me vëllimin e madh dhe natyrën e komplikuar të këtyre ngjarjeve, por kjo mund të vijë edhe si rezultat i moshës relativisht të re të mediave të ashtuquajtura të pavarura, dhe vetë gazetarisë profesionale në vend.

Si rezultat, publikut shpesh i serviren raportime që mbështeten në fakte, por nuk jepen informacione më të thella mbi kontekstin dhe realitetin që i rrethon këto ngjarje, çka do t'i bënte më të kuptueshme dhe më të qarta informacionet dhe faktet. Në Shqipëri, mediat i kushtojnë shumë pak vëmendje

analizës se ku qëndron çelësi i suksesit të propagandës xhihadiste, dhe arsyes përse kjo propagandë tërheq ndjekës; prejardhjes shoqërore të rekrutëve dhe rrethanat e tyre ekonomike dhe kulturore; dhe sidomos marrëdhëniet e tyre me familjen dhe shoqërinë.

Gjatë analizës së raportimit mediatik duhet të merret parasysh edhe natyra multifetare e Shqipërisë dhe historia e saj. Politikanë, klerikë dhe personalitete të tjera promovojnë vazhdimisht harmoninë ndërfitetare si një histori shqiptare suksesi. Deklarata të tilla përsëriten shpesh në media, veçanërisht gjatë festave fetare. Sidoqoftë, valëvitja e përhershme e flamurit të harmonisë, edhe kur një pjesë e shoqërisë përfshihet në akte terroriste, si në rastin e të ashtuquajturve luftëtarë të huaj që bashkohen me ISIS, do të thotë të injorosh një pjesë të shoqërisë aktuale shqiptare dhe të shikosh vetëm pjesën pozitive të tablosë.

Ka shumë pyetje të mbetura pa përgjigje: Pse grupet ekstremiste, që janë pjesë e komunitetit, kanë devijuar nga tradita e tolerancës fetare që daton që nga koha e Perandorisë osmane? Çfarë ka ndryshuar, dhe më e rëndësishmja, çfarë mund të bëjë qeveria dhe shoqëria për të ndrequr këtë problem? Këto pyetje shpesh injorohen nga debati publik, dhe ky nuk është thjesht një problem i medias. Duhet të angazhohemi në një diskutim më të gjerë që të përfshijë një rreth shumë më të gjerë faktorësh, nga të gjitha shtresat e shoqërisë.

Gazetarët dhe mediat e ditëve tona kanë përgjegjësi për informimin e publikut, por kjo është bërë akoma më e vështirë në epokën e dezinformimit, kur publiku bie viktimë e informacioneve “të rreme,” ndonjëherë edhe si rezultat i propagandës së prodhuar nga grupe ekstremiste ose terroriste.

Kjo situatë e krijuar së fundmi kërkon që të arrihet një vetëdije e re etike dhe profesionale. Në këtë kontekst, kapitujt

e mëposhtëm do të përpiqen të ofrojnë udhëzime që mund të ndiqen nga media gjatë raportimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit. Këto udhëzime bazohen pjesërisht në manuale dhe tekste ndërkombëtare, në manualin e UNESCO-s për gazetarët *Terrorizmi dhe Media*, në udhëzime të tjera profesionale, si dhe në përvojën e deritanishme të raportimit mbi ekstremizmin e dhunshëm nga media shqiptare.

Në kapitujt e mëposhtëm analizohet baza ligjore aktuale që prek mbulimin në media; parimet themelore të punës redaksionale dhe raportimit; nuanca dhe tipare të veçanta për t'u marrë parasysh kur raportohet mbi terrorizmin; roli i mediave sociale; si dhe problemi i gjuhës së urrejtjes në nxitjen e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.

Gazetarët etikë nganjëherë i rezistojnë me të drejtë leksioneve që u japin të tjerët mbi mënyrën si ta bëjnë punën e tyre, kështu që e pranojmë se raportimi mbi terrorizmin nuk mund të ndreqet thjesht nga përpilimi i një manuali udhëzues me rregulla të rrepta. Për këtë arsye, këto sugjerime ofrohen si udhëzime të mundshme, duke i dhënë reporterëve dhe redaktorëve që mbulojnë këto çështje disa këshilla dhe ide që mund t'i ndihmojnë në përballje me sfidat profesionale që hasin në punën e tyre të përditshme.

## 2

### Përkufizimet e terrorizmit

Dhuna ekstremiste në shërbim të objektivave politike, fetare ose të ndonjë natyre tjetër ka qenë një shoqëruese brutale dhe tragjike e jetës moderne për dekada me radhë, por nuk është arritur akoma që të formulohet një përkufizim i kënaqshëm mbi terrorizmin.

Është e vështirë të gjendet një përkufizim për të cilin të bien dakord të gjithë, edhe meqë pikëpamjet individuale shpesh bazohen në bindje të ndryshme politike, fetare, kulturore, etj. Për shembull, ndërkohë që dhuna për motive politike që përfshiu Italinë apo Gjermaninë në vitet 1970 mund të konsiderohej si aktivitet terrorist, personat që kryenin këto akte i justifikonin veprimet e tyre si një mënyrë legjitime për realizimin e objektivave të tyre ideologjike.

Ashtu siç thekson Jean-Paul Marthoz në manualin e UNESCO-s për gazetarët, disa fraza të caktuara që përdoren në këtë kontekst janë bërë klishe. Për të ilustruar kompleksitetin e këtij problemi ai përmend shprehjet “Ai që konsiderohet terrorist nga një person, quhet luftëtar i lirisë nga dikush tjetër,” si dhe “Terroristi i sotëm mund të bëhet burrë shteti nesër.”<sup>1</sup>

Përveç kësaj, ky term mund të keqpërdoret edhe nga faktorë që kanë interesa të caktuara. Për shembull, ndërsa një

---

<sup>1</sup> Jean-Paul Marthoz, *Terrorizmi dhe media (Terrorism and the media)* UNESCO, 2017.

diktaturë ose një regjim autoritar mund të përcaktojë një grup guerilas si organizatë terroriste, një pjesë e shoqërisë mund ta konsiderojë si një lëvizje rezistence legjitime. Pavarësisht nga dallimet dhe nuancat e holla në përkufizim, pranohet gjerësisht që një akt terrorizmi zakonisht përfshin akte të dhunës ekstreme pa kriter, që shpesh kryhen kundër civilëve, me taktika që nuk miratohen nga lëvizje dhe grupe të tjera.

Ndonëse Kombet e Bashkuara nuk kanë hartuar një përkufizim të pranuar botërisht nga të gjithë, OKB zakonisht konsideron akt terrorist

*“çdo akt, përveç akteve të specifikuara tashmë nga konventat ekzistuese mbi aspektet e terrorizmit, Konventat e Gjenevës dhe rezoluta e Këshillit të Sigurimit 1566 (2004), që synon të shkaktojë vdekje ose dëmtim të rëndë fizik ndaj civilëve ose jo-luftëtarëve, kur qëllimi i një akti të tillë, nga natyra ose konteksti në të cilin zhvillohet, është të ngjallë frikë në popullatë, ose të detyrojë një qeveri ose organizatë ndërkombëtare të ndërmarrë ose të heqë dorë nga ndonjë veprim.”<sup>2</sup>*

Ndonëse ky përkufizim është i dobishëm, lë hapësira për interpretim dhe paqartësi në raport me miratimin e legjislacioneve dhe politikave kombëtare si pasojë e përdorimit të frazës “që synon.” Si mund të përcaktohet dhe përkufizohet në mënyrë objektive një “synim”? Për shembull, gjatë “trazirave” (*troubles*) në Irlandën e Veriut, gati 3.000 njerëz u vranë gjatë një periudhe që zgjati për 30 vjet, deri në fund të viteve 1990. Shumë prej viktimave ishin civilë, që mbetën të vrarë si rezultat i akteve terroriste nga ana e grupeve paraushtarake në Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandë, por vetë terroristët përpiqeshin që të justifikonin dhe shfajësonin aktet e tyre, ndërsa mundoheshin të shmangnin viktimat në

---

<sup>2</sup> Po aty.

publik, duke paralajmëruar autoritetet në telefon pak para se të shpërthenin bombat.

Përveç terrorizmit, ka edhe terma të tjera të rëndësishme që përdoren shpesh në raport me zhvillimet e kohëve të fundit si ekstremizmi, radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm.<sup>3</sup>

- **Ekstremizmi** mund të vërehet atëherë kur një objektiv ideologjik merr përparësi në raport me shumicën e elementëve dhe faktorëve të tjerë. Në rastet kur tregohet respekt për jetën dhe të drejtat e të tjerëve, ekstremizmi paraqet pak rrezik nga këndvështrimi i antiterrorizmit. Sidoqoftë, ekstremizmi bëhet problematik nëse promovon në mënyrë pasive ose aktive përdorimin e dhunës si mjet për të përmbushur një qëllim, ose nëse krijon një atmosferë frike dhe pasigurie ku mund të lulëzojë terrorizmi.
  
- **Radikalizmi** është procesi nëpërmjet të cilit një individ ose një grup i caktuar bindet të pranojë dhe të përqafojë përdorimin e dhunës ose kërcënimin e kryerjes së akteve të dhunës si një mjet për të arritur një qëllim të caktuar politik, fetar, ose ndonjë qëllim tjetër ideologjik. Radikalizëm do të thotë të bëhesh më radikal në bindjet e tua ideologjike, politike ose fetare (është e rëndësishme të kuptohet se ideologjia në këtë rast nuk ka pse të jetë domosdoshmërisht fetare). Një person që ka adoptuar besime ekstreme konsiderohet se është radikalizuar.  
Radikalizmi që çon në ekstremizëm të dhunshëm është një proces nëpërmjet të cilit një individ anon

---

<sup>3</sup> Hyrje në CVE (Introduction to CVE), Hedayah (e papublikuar), Cristina Mattei dhe Sara Zeiger.

nga pranimi dhe përvetësimi i dhunës për të arritur qëllime ideologjike. Ky është një proces që varet nga një kombinim i rrethanave individuale dhe faktorëve të jashtëm, si situata e përgjithshme politike, kulturore ose shoqërore.

- **Ekstremizmi i dhunshëm**, që mund të konsiderohet si faza e fundit e procesit të radikalizmit, i referohet akteve dhe opinioneve të individëve që përligjin ose përdorin dhunë të motivuar ideologjikisht për të arritur qëllime politike, fetare ose ideologjike. Ekstremistë të dhunshëm nuk janë vetëm ata që janë të gatshëm të ndër marrin dhunë fizike, por edhe ata që mbështesin, rekrutojnë ose mbrojnë në mënyrë aktive një ideologji ekstremiste të dhunshme. Ekstremizmi i dhunshëm dhe elementë të tjerë të radikalizmit shpesh ushqehen nga gjuha e urrejtjes.

Ndonëse mund të jetë e vështirë për të rënë dakord plotësisht mbi këto përkufizime, në varësi të perceptimeve, bindjeve dhe kontekstit personal, është me rëndësi thelbësore që gazetarët të kenë një njohje sa më të mirë të këtyre termave dhe koncepteve. Mënyra se si gazetarët dhe redaktorët raportojnë mbi terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm formëzon perceptimin e publikut në lidhje me ngjarjet. Përgjatë raportimit të akteve të dhunës të kësaj natyre ata duhet të jenë të mirinformuar dhe t'i përdorin këto terma me kujdes dhe saktësi.

# 3

## Normat ligjore, politikat kombëtare dhe ndikimi mbi median

Në Shqipëri, një sërë nismash ligjore dhe dokumentesh zyrtare merren drejtpërdrejt me terrorizmin, ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin. Secila prej këtyre materialeve strategjike ose ligjore përqendrohet në aspekte specifike të terrorizmit, si masat kundër financimit, denoncimit, ose luftës kundër terrorit. Së bashku, ato përbëjnë kuadrin strategjik dhe ligjor mbi terrorizmin, dhe shërbejnë si pika referimi edhe për mediat, gazetarët dhe organizatat e shoqërisë civile.

Nismat ligjore dhe strategjike që lidhen me median dhe gazetarët janë: *Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Ligji për Shërbimet e Mediave Audiovizive në Republikën e Shqipërisë, Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, si dhe Ligji për Masat Kundër Financimit të Terrorizmit.*

Në kapitujt që vijojnë do të përqendrohemi në secilin prej këtyre elementeve, duke dhënë një përshkrim të shkurtër dhe shpjegim se si secila prej tyre lidhet me funksionimin e mediave dhe me rolin e gazetarëve.



- **Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë<sup>4</sup>**

Kodi Penal është përditësuar për herë të fundit në vitin 2020, dhe rendit aktet e terrorizmit që përbëjnë vepra penale në Kreun VII të Pjesës II. Aktet terroriste përkufizohen si veprime që synojnë përhapjen e panikut në popullatë, ose që mundohen të detyrojnë organe shtetërore, shqiptare ose të huaja, për të kryer ose për të mos kryer një veprim të caktuar. Po kështu, klasifikohen si akte terroriste edhe përpjekjet për të shkatërruar ose destabilizuar strukturën bazë politike, kushtetuese, ekonomike ose shoqërore të shtetit shqiptar, të një shteti, institucioni apo organizate tjetër ndërkombëtare. Këto vepra penale dënohen me burgim jo më pak se 15 vjet, ose me burgim të përjetshëm.

Aktet me qëllim terrorist që mund të kenë të bëjnë me median dhe gazetarët përfshihen në Nenin 230/e:

Përhapjen e informacioneve që dihet se janë të pavërteta, duke rrezikuar sigurinë e një avioni në fluturim apo të anijes në lundrim.

Gjithashtu, Neni 230/c thotë që “Vënia në dijeni e personave të shpallur ose e personave të tjerë për të dhënat për verifikimin ose hetimin e fondeve dhe pasurive të tjera, ndaj të cilave zbatohen masa kundër financimit të terrorizmit, nga persona që ushtrojnë funksione publike ose që janë në ushtrim të detyrës a profesionit, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.”

Më tej, Neni 232/a thotë: Nxitja, thirrja publike, shpërndarja e shkrimeve ose propaganda në forma të tjera, që synon mbështetjen apo kryerjen e një apo më shumë veprave për qëllime terroriste dhe për financimin e terrorizmit, nëse nuk

---

<sup>4</sup> Mund të lexohet te: <https://qbz.gov.al/preview/a2b117e6-69b2-4355-aa49-78967c31bf4d>

përbën veprë tjetër penale, dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.

Ndërsa Neni 267 thotë: Përhapja e informatave apo njoftimeve të rreme, me fjalë, me shkrim apo me çdo mënyrë tjetër, me qëllim që të ngjallë një gjendje pasigurie dhe paniku te njerëzit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Të gjitha këto nene duhet të mbahen parasysh nga media dhe gazetarët në mënyrë që të shmangen akuzat për mbështetje, promovim ose përfshirje, me qëllim ose pa dashje, në veprime që ligji i konsideron si akte terroriste. Gazetarët duhet të dinë si të veprojnë kur hasin në informacion që ka lidhje me terrorizmin, dhe të tregojnë kujdes dhe gjykim të shëndoshë në lidhje me informacionin ose lajmet që botojnë.

- **Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm**

Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit është shprehje e angazhimit të Shqipërisë për të luftuar kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit. Kjo strategji synon të kultivojë kulturën e respektit për liritë themelore në të gjithë vendin, të ruajë vlerat e tolerancës dhe harmonisë fetare, të mbrojë të drejtat e njeriut, shtetin e së drejtës dhe demokracinë, si dhe të mbrojë shoqërinë shqiptare nga ekstremizmi i dhunshëm.

Objektivi kryesor i strategjisë është të forcojë punën e faktorëve të ndryshëm që përpiqen të luftojnë ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri, dhe të promovojë masa për zgjidhjen e problemeve që çojnë në radikalizëm. Masat e propozuara nga kjo strategji në lidhje me mediat dhe gazetarët, përfshijnë:

- a) forcimin e bashkëpunimit dhe partneritetit në nivel lokal, kombëtar e ndërkombëtar, mes agjencive qeveritare, organizatave joqeveritare, sektorit privat, bashkësive fetare dhe medias, në përcaktimin dhe

zbatimin e ndërhyrjeve efektive që do të ulin ndikimin e propagandës së ekstremizmit të dhunshëm dhe rekrutimit në internet, për shembull, duke shfrytëzuar mediat sociale për hartimin dhe përçimin e mesazheve alternative pozitive;

- b) Kundërvënia ndaj propagandës ekstremiste, duke përkrahur vlerat demokratike, për t'iu kundërvënë mesazheve të ekstremizmit të dhunshëm, sidomos përçimit të tij përmes materialeve dhe mesazheve të fushatave në internet.

Strategjia Kombëtare paraqet një qasje dykahëshe për diskreditimin dhe dobësimin e ndikimit të propagandës ekstremiste. Grupi i punës mbi komunikimin, ku përfshihen zyrtarë shtetërorë, akademikë, media dhe shoqëritë teknologjike, shoqëria civile, komunitetet fetare dhe punonjës të vijës së frontit, duhet të luajë një rol të dorës së parë në kryerjen e këtij misioni.

Në këtë drejtim, shoqëria civile, komunitetet fetare, dhe media, duhet të hartojnë dhe promovojnë përçimin e një narrativave alternative në mbështetje të tolerancës, paqes, të drejtave të njeriut dhe vlerave demokratike. Strategjia përfshin fushata të përshtatura për mediat sociale, programe radiotelevizive, si dhe lloje të tjera nismash që janë në gjendje të depërtojnë tek audiencat e synuara. Bazuar në këtë strategji, media dhe gazetarët luajnë një rol të rëndësishëm në hartimin dhe shpërndarjen e mesazheve kundër të gjitha formave të ekstremizmit të dhunshëm, radikalizmit dhe terrorizmit.

- **Ligji për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë**

Ligji për Mediat Audiovizive, i përditësuar për herë të fundit në vitin 2019, rregullon veprimtarinë, të drejtat, detyrimet

dhe përgjegjësitë e individëve dhe organizatave që ofrojnë shërbime audio, audiovizive dhe elektronike, përmes rrjetit të komunikimeve elektronike, si dhe promovimin e pluralizmit të medias, në përputhje me konventat dhe standardet ndërkombëtare.

Ligji zbatohet si për transmetimet tradicionale audiovizive, ashtu edhe për transmetimet sipas kërkesës së abonentit, duke përfshirë edhe shërbimet mbështetëse të kompanive dhe botimet elektronike. Ky ligj nuk aplikohet për mediat e shkruara. Në fakt, media e shkruar rregullohet vetëm me një ligj që thotë se shtypi është i lirë dhe ndalohet censura paraprake. Nga ana tjetër, ligji për mediat audiovizive është goxha i detajuar.

Rëndësi të veçantë ka neni 132, paragrafi 5, i cili thotë se përmbajtja e botuar nga Ofruesi i Shërbimeve të Publikimeve Elektronike (EPSP) që përbën një vepër penale, mund t'i nënshtrohet ndëshkimeve të parashikuara nga rregullatori, Autoriteti i Mediave Audiovizive. Përmbajtja që konsiderohet vepër penale përfshin, ndër të tjera, veprime me qëllim terrorist dhe cenim të sigurisë kombëtare. Për shkelje të rregullave mund të vendosen sanksione, duke përfshirë heqjen e materialeve të botuara dhe bllokimin e aksesit në këtë përmbajtje, dhe gjithashtu mund të përfshijnë edhe detyrimin për të vendosur një njoftim “pop-up” në faqen e internetit të medias duke dhënë informacion mbi vendimet e AMA-s.

Sipas frymës së këtij ligji, organet e medias, gazetarët dhe profesionistët tjerë duhet të jenë të kujdesshëm në përgatitjen e materialeve mediatike në mënyrë që të sigurohen se nuk do kryhen, mbështeten apo promovohen akte e qëllime terroriste. Deri më sot nuk ka patur vendime ose vërejtje specifike nga rregullatori për shpërndarjen e përmbajtjeve mediatike që mund të konsiderohen si terroriste. Ndërkohë, është e rëndësishme të kujtojmë se, pavarësisht nga ndërmarrja e një

nisme për të zgjeruar juridiksionin e AMA-s mbi mediat në internet, për momentin rregullatori është përgjegjës vetëm për mediat audiovizive.

- **Ligji për masat kundër financimit të terrorizmit**

Ky ligj, në përputhje me rezolutat përkatëse të Kombeve të Bashkuara, dhe aktet e organizatave të tjera ndërkombëtare ose marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga Shqipëria, synon të parandalojë dhe godasë terroristët dhe ata që financojnë terrorizmin, ose ata për të cilët ekzistojnë dyshime të arsyeshme të kenë kryer, se po kryejnë ose synojnë të kryejnë veprimtari të tilla. Kjo mund të çojë në bllokimin dhe sekuestrimin e fondeve dhe pronave.

Neni 10, pika 2 e këtij ligji ka të bëjë me rolin e gazetarëve dhe medias. Ai detyron cilindo që ka njohuri mbi veprime financiare, transaksione, fonde ose aktivitete të tjera, të kryera ose që përpiqen të kryhen, me qëllim kryerjen ose financimin e akteve terroriste, të njoftojë menjëherë organet e zbatimit të ligjit ose Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimi të Pastrimit të Parave.

Njoftimi dhe raportimi i informacionit duhet të përmbajë të dhëna për identifikimin e fondeve dhe pasurive të tjera, të dhëna mbi pronësinë dhe interesa të tjera të lidhura me to, si dhe shpjegime për motivet ku bazohen dyshimet e arsyeshme për financimin e terrorizmit.

Ligji mbron gjithashtu identitetin e atyre që japin informacione (individë, subjekte raportuese ose punonjës) nga organet që marrin informacionin. Po kështu, neni 12 thekson ndalimin e publikimit të të dhënave. Të dhënat e siguruar në zbatim të këtij ligji mund të përdoren vetëm për qëllimet e zbatimit të ligjit, për qëllime të ndjekjes penale ose

për qëllime të tjera, të caktuara me ligji. Organet përgjegjëse, subjektet raportuese dhe personat e punësuar pranë tyre, që marrin të dhëna, njoftime dhe raportime në zbatim të këtij ligji, nuk mund të bëjnë publike fakte, për të cilat janë vënë në dijeni gjatë këtij procesi.

# 4

## Parimet themelore të raportimit mediatik mbi terrorizmin

Kodi i Etikës për Gazetarët Shqiptarë nuk merret posaçërisht me mbulimin e terrorizmit, por përmban një seksion kundër nxitjes së krimit dhe dhunës që thotë: *“Dhuna dhe brutaliteti nuk duhen sensacionalizuar. Raportimi duhet të marrë parasysh nevojën për të mbrojtur minorenët dhe grupet vulnerabël të shoqërisë. Gazetarët dhe media nuk duhet të glorifikojnë krimet dhe terrorizmin, apo ndonjë veprimtari mizore apo çnjerëzore.”*<sup>5</sup>

Shmangia e glorifikimit të dhunës dhe akteve terroriste është një sfidë serioze me të cilën përballen mediat kur raportojnë për terrorizmin, dhe që duhet të merret parasysh në çdo moment.

Parimet e raportimit mbi terrorizmin - për të informuar publikun në mënyrë të drejtë, të pavarur dhe të paanshme - nuk ndryshojnë nga parimet thelbësore të gazetarisë etike, por duke pasur parasysh natyrën komplekse të terrorizmit dhe dhunës ekstreme, grupet dhe njerëzit e përfshirë, potencialin për të ndjellë frikë dhe zemëratë te publiku i gjerë, si dhe rrezikun që mediat t'i shërbejnë pa dashje qëllimeve të terroristëve, gazetarët dhe redaktorët duhet të jenë vigilentë dhe mbulimi mediatik në këtë fushë duhet të jetë i kujdesshëm dhe të reflektojë pjekuri.

---

<sup>5</sup> Kodi i gazetarëve shqiptarë, 2018.

- **Në kërkim të së vërtetës.**

Misioni kryesor i gazetarisë është raportimi i saktë dhe përcimi i informacionit të bazuar në fakte. Kjo kërkon verifikim të vazhdueshëm të fakteve dhe konfirmim të informacionit për t'u siguruar mbi saktësinë e lajmit. Edhe pse nuk është gjithmonë e mundur të zhvillohet ky proces në kulmin e punës për raportimin të ngjarjeve të orës së fundit, kur situata ndryshon me shpejtësi, duhet bërë çdo përpjekje e mundshme për të vërtetuar saktësinë e të dhënave dhe fakteve.

Përveç kësaj, raportimi duhet të përfshijë edhe sfondin dhe kontekstin në të cilin zhvillohet ngjarja, të kërkohet të gjendet shpjegimi për akte të tilla, si dhe ndikimi i tyre i mundshëm në shoqëri. Ashtu siç thekson Marthoz në manualin e UNESCO-s *“brutaliteti i një akti të dhunshëm nuk mund të shërbejë si pretekst për të refuzuar analizimin e shkaqeve të tij.”*<sup>6</sup> Që nga momenti i parë gjatë raportimit mbi terrorizmin, dhe veçanërisht në raportimet e orëve të para nga terreni, gazetarët duhet të përqendrohen vetëm tek faktet, duke lënë hapësirë për analiza të hollësishme dhe të kujdesshme më vonë.

- **Raportimi i pavarur.**

Nga vetë natyra e tij, terrorizmi ka për qëllim të tërheqë vëmendjen, të ngjallë frikë e pasiguri, dhe të provokojë emocione të forta. Në këtë aspekt, është e natyrshme që gazetarët kanë prirje të reagojnë ndaj ngjarjeve të tilla në mënyrë njerëzore, duke u solidarizuar me viktimat dhe komunitetin e tyre. Të tregosh ndjeshmëri dhe të jesh i njerëzishëm është e rëndësishme në gazetari, por kjo nuk

---

<sup>6</sup> Jean-Paul Marthoz, Terrorizmi dhe media (Terrorism and the media) UNESCO, 2017.



duhet të shkaktojë dhënien e opinioneve negative apo shfaqjen e emocioneve personale në raportim. Faktet duhet të flasin vetë, duhen shmangur thashethemet e spekulimet, dhe të paraqitet sfondi dhe konteksti përkatës kur të jetë momenti i duhur. Në këtë mënyrë reporterët dhe redaktorët mund t'u përmbahen vlerave dhe standardeve themelore të gazetarisë, që të mos bëhen pa dashje vegël e terroristëve të uritur për publicitet, dhe të mos e përkeqësojnë më tej situatën.

- **Respektimi i dinjitetit njerëzor dhe e drejta për privatësi.**

Gjetja e ekuilibrit të duhur midis të drejtës së publikut për të marrë informacion dhe nevojës për të respektuar jetën private dhe dinjitetin janë gjithashtu pjesë e punës së reporterit. Në momente krize, media bëhet një nga burimet më të besueshme të informacionit për publikun, dhe për të bërë të mundur që cilësia e informacionit t'i përmbahet standardeve më të larta është e rëndësishme që të përdoret një filtër profesional, në mënyrë që publiku të marrë informacionin që i nevojitet për të kuptuar sa më mirë se çfarë ka ndodhur. Është gjithashtu e rëndësishme që të jemi të vetëdijshëm se mbulimi mediatik ndikon në jetën e njerëzve të përfshirë në këto ngjarje, si viktimat, banorët vendas dhe komunitetet e prekura, çdo person i marrë peng, si dhe ata që punojnë për zbatimin e ligjit dhe mbrojtjen e rendit publik.

Nuk ekziston ndonjë formulë e gatshme për të përcaktuar se ku duhet të vendoset kufiri midis nevojës për informim dhe detyrimit moral për të mos i shkaktuar dëm personave të pafajshëm, por të gjitha vendimet redaksionale që mund të ndikojnë në jetën e të tjerëve kërkojnë kohë dhe reflektim. Gazetaria etike është gazetari inteligjente, dhe reporterë e redaktorë duhet të mos nxitohen dhe t'i kushtojnë kohën

e nevojshme reflektimit dhe analizimit të raportimit. Mbi të gjitha, duhet t'i bëjnë ballë tundimit për të publikuar sa më shpejt, edhe kur kjo bie ndesh me prirjen dhe refleksin profesional për të qenë të parët në raportimin e lajmit.

# 5

## Aspekte të veçanta që duhen patur parasysh kur raportohet për terrorizmin

Raportimi i terrorizmit mbart me vete një barrë emocionale dhe profesionale, dhe për këtë arsye kapitujt e mëposhtëm analizojnë disa nga dilemat dhe aspektet e mundshme që duhen mbajtur parasysh nga gazetarët, duke u përpjekur të japim informacione që mund të ndihmojnë gazetarët në punën e tyre.

### **5.1 Burimet e informacionit**

Aktet e terrorizmit shkaktojnë thujtë gjithmonë një gjendje tronditjeje, pështjellimi dhe pasigurie. Në këto situata raportimi bëhet jashtëzakonisht i vështirë, veçanërisht në rastet e transmetimeve të drejtpërdrejta. Ndonëse zakonisht reporterët kanë akses në burimet lokale të informacionit, sidomos pranë vendit të ngjarjes, është shumë e rëndësishme që të sigurohet akses dhe të merret informacion nga burime zyrtare. Kjo mund të shmangë çdo panik, konfuzion dhe zemëratë tek publiku, veçanërisht në ato raste kur informacioni i siguruar nga burime të tjera

nuk mund të verifikohet në mënyrë të pavarur. Kontakti i drejtpërdrejtë me zyrtarët dhe organet kompetente, si dhe përçimi i informacionit nga njoftimet dhe deklaratat zyrtare për shtyp mund të jenë zgjidhja më e sigurt.

Sidoqoftë, kur informacioni zyrtar vonohet ose është i pamjaftueshëm, gazetarët zakonisht i drejtohen burimeve të tjera, dhe shpesh pranojnë që të mbajnë fshehur identitetin e këtyre burimeve. Nganjëherë gazetarët mund të përdorin edhe informacione që vijnë nga denoncime nga persona të brendshëm (*whistle-blowers*) ose edhe nga individë që marrin pjesë ose që flasin në emër të organizatave terroriste, por kjo duhet bërë vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. Në këto raste gazetarët duhet të jenë jashtëzakonisht të kujdesshëm dhe të përdorin filtra në përçimin e informacionit që marrin.

Gazetarët duhet ta kenë veçanërisht të qartë se cili është burimi i informacionit - edhe në rastet kur duhet të mbajnë fshehur identitetin e personit gjatë raportimit të tyre. Gazetarët duhet të jenë të vetëdijshëm në lidhje me rrezikun që paraqet kontakti dhe puna me njerëz që kanë interesa personale në situata të caktuara, dhe duhet të shmangin çdo raportim që mund të komprometojë neutralitetin dhe pavarësinë e punës së tyre. Informacioni i dhënë nga persona që dëshirojnë të mbeten anonimë duhet të analizohet dhe verifikohet me kujdes përpara publikimit - a është i bazuar në fakte? Mos vallë pasqyron këndvështrimin e një personi të vetëm? A krijon paragjykim në favor të njëjës palë? A e ndihmon publikun që të kuptojë më mirë çfarë ka ngjarë? Këto janë disa nga pyetjet kryesore që gazetari duhet të shtrojë përpara vetes kur bie fjala tek përdorimi i informacionit nga burime të fshehta që nuk njihen nga publiku.

## 5.2 Raportimi për autorët e akteve

Po kështu, është mirë që media të presë konfirmimin zyrtar përpara se të identifikojë personin apo grupin përgjegjës për aktet e terrorizmit. Spekulumet apo thashethemet lidhur me personat përgjegjës nuk duhet të jenë pjesë e raportimit në media, pasi kjo mund të ngjallë panik dhe konfuzion te publiku.

Një tjetër parim që duhet të kemi gjithmonë parasysh është prezumimi i pafajësisë; nëse nuk ka konfirmim zyrtar të emrave të personave përgjegjës, nuk është me vend që media të etiketojë persona të caktuar si terroristë. Për shembull, shumë media në raportimet e para pas një incidenti duhet t'i referohen ngjarjes si një akt dhune, ndërsa autorëve duhet t'i referohen si "persona përgjegjës," apo "keqbërës". Përdorimi i termit "terrorizëm," dhe etiketimi i personave si "terroristë" mund të shkaktojë alarm të panevojshëm te publiku. Pritja e konfirmimit zyrtar dhe vërtetimit të informacionit ndihmon në forcimin e besimit të publikut ndaj medias dhe informacionit që marrin prej saj.

Madje, edhe pas konfirmimit zyrtar media duhet të ketë kujdes. Media mund të bjerë në gracka të momentit që mund të çojë në mbështetje të paqëllimshme të objektivave dhe taktikave terroriste, duke u dhënë autorëve të akteve terroriste hapësirë të gjerë mediatike, portretizim me nota pozitive ose negative në raportim, ose duke u atribuar një rëndësi të veçantë në sytë e një pjese të publikut.

Po aq e rëndësishme është që media të mos etiketojë terrorizmin si një problem me origjinë nga një vend, grup etnik, ose fe e caktuar. Aktet e terrorizmit kryhen nga individë ose nga organizata terroriste, dhe transferimi i kësaj përgjegjësie apo etikimi injë vendi të tërë, rajoni, etnie ose feje mund të përshkallëzojë më tej tensionet dhe të krijojë një klimë

mosbesimi midis komuniteteve dhe rajoneve të ndryshme të botës. Natyrisht që kjo është edhe një nga objektivat e terrorizmit. Për këtë arsye është e rëndësishme që mediat të mos i referohen kurrë “terrorizmit islamik” por të jenë më të qartë e të saktë kur i referohen individëve ose organizatave specifike, si ISIS-i, ose nëse është e përshtatshme të përdoret edhe termi “terrorizmi xhihadist.”

### **5.3 Raportimi për viktimat dhe të mbijetuarit**

Raportimi mediatik mbi terrorizmin e vendos gazetarin përballë sfidës të balancimit të nevojave të profesionit me etikën humaniste; informimit të publikut mbi ngjarje dhe fenomene të një rëndësie të veçantë, ndërkohë që duhet shmangur shkaktimi i dëmeve të mëtejshme ndaj viktimave ose të mbijetuarve.

Identiteti i viktimave të terrorizmit duhet të zbulohet vetëm pas konfirmimit zyrtar, dhe vetëm pasi të afërmit e viktimës të jenë njoftuar nga autoritetet. Në garë për përçimin sa më të shpejtë të lajmeve nga mediat shqiptare, të afërmit e viktimave janë informuar disa herë nga raportimet drejtpërdrejt në media për vdekjen e të dashurve të tyre (në incidente që nuk lidheshin me terrorizmin,). Kjo tregon, edhe një herë, që duhet shmangur nxitimi i tepruar për të publikuar informacione të caktuara.

Ekzistojnë politika dhe praktika të ndryshme brenda profesionit të gazetarisë mbi qëndrimet e redaksive të lajmeve në lidhje me pamjet e trupave të viktimave, si në akte terroriste, aksidente apo katastrofa humanitare. Disa organe mediatike preferojnë të mos i tregojnë këto pamje për të treguar respekt për viktimat, dhe për të shmangur publikimin e pamjeve që i shkojnë për shtat objektivave të terroristëve, ndërsa media të tjera mund të zgjedhin t'i tregojnë trupat

e viktimave në mënyrë që publiku të njihet me pasojat e terrorizmit, si dhe për të eliminuar teoritë e konspiracionit që mund të lindin nga fshehja e materialeve të tilla.

Disa media publikojnë profile dhe portrete të viktimave në ditët pas ngjarjeve tragjike. The Guardian vendosi të humanizojë historitë e viktimave pas sulmeve terroriste në Paris në vitin 2005, ndërsa *The New York Times* pas sulmeve në New York dhe Washington në vitin 2001, botoi histori individuale me fotografi që tregonin jetën e përditshme të viktimave, duke përkujtuar jetën e tyre dhe duke ekspozuar më tej natyrën çnjerëzore të akteve terroriste.

Duhet të theksojmë (dhe do të merremi më poshtë me këtë çështje) se në momentet e para pas ngjarjeve, madje edhe ndërsa nuk ka përfunduar ende sulmi terrorist, në mediat sociale shpesh publikohen imazhe të qarta të vdekjes dhe shkatërrimit pa menduar për ndikimin e tyre në publik. Natyrisht që kjo nuk është gazetari, pasi standardet profesionale kërkojnë që materiali të filtrohet dhe analizohet përpara publikimit, për të arritur në një ekuilibër të pranueshëm ndërmjet raportimit të së vërtetës dhe nevojës për të marrë në konsideratë ndikimin mbi viktimat, të mbijetuarit dhe grupet e ndjeshme si fëmijët, dhe gjithë shoqërisë në përgjithësi.

Natyrisht që të mbijetuarit e terrorizmit kanë të drejtën e privatësisë. Nga ana tjetër, pasqyrimi i zërit të të mbijetuarve në raportimet e medias mund të sigurojë informacion të vyer dhe autentik, për të cilin publiku është i interesuar dhe që është i rëndësishëm për t'u dëgjuar. Por reporterët duhet të tregojnë kujdes kur intervistojnë të mbijetuarit e këtyre incidenteve. Nuk duhet të bëjnë pyetje që mund të shkaktojnë edhe më shumë traumë apo të shtojnë vuajtjet, dhe duhet të sigurohen që i mbijetuari është dakord që të intervistohet.

Kujdesi dhe ndjeshmëria në punë nuk janë të nevojshme vetëm kur raportohet mbi sulmin terrorist. Menjëherë pas aksidenteve, fatkeqësive ose krimeve mediat nuk duhet të bien në grackën e intervistave dhe citateve emocionale nga të mbijetuarit. Kjo lloj gazetarie rrallë sjell ndonjë informacion të dobishëm për publikun, dhe zakonisht vetëm sa shkakton shqetësime dhe brenga të mëtejshme.

#### **5.4 Publikimi i imazheve**

Publikimi dhe përhapja e imazheve ose pamjeve filmike të dhunshme apo tronditëse nga terrorizmi dhe akte të dhunës ekstreme është një nga taktikat kryesore të terroristëve; sa më të ashpra dhe të përgjakshme të jenë këto imazhe, dhe sa më shumë njerëz t'i shohin ato, aq më shumë i afrohen realizimit të dy objektivave të tyre - së pari, përhapja e frikës dhe pasigurisë në publik, dhe së dyti, të frymëzojnë të rinjtë e pakënaqur që të radikalizohen dhe të dalin në mbështetje të akteve të tilla dhune. Kjo shpjegon edhe taktikat e përdorura nga terroristët, që kanë një prani më të madhe në internet me përdorimin e mediave sociale, apo edhe krijimin e mediave të tyre.

Përballë sofistikimit në rritje të metodave dhe mjeteve të përdorura nga terroristët, një nga dilemat e hershme të medias ka dalë më shumë se kurrë në qendër të vëmendjes: cilat imazhe duhet të shfaqen nga aktet terroriste dhe në çfarë mënyre? A duhet të ndalohej plotësisht publikimi i këtyre imazheve, siç kanë vendosur disa media, apo duhet të raportohen në një mënyrë etike në shërbim të interesit publik?

Media të ndryshme kanë përqasje të ndryshme. Për shembull, një nga çështjet më problematike ka qenë trajtimi i pamjeve filmike të prerjes së kokave që shpërndaheshin nga ISIS. Disa media zgjedhën të botonin vetëm fotografi



ose imazhe të palëvizshme, dhe jo vetë aktin; media të tjera botuan njëkohësisht edhe fotografi të viktimave në jetën normale; ndërsa disa organe mediatike nuk botuan asnjë material në lidhje me pamjet filimike të kësaj natyre.

Rreziku i shndërrimit në një vegël të propagandës terroriste bëhet veçanërisht i dukshëm në rastet e publikimit të imazheve dhe videove të gatshme për median. Kjo u shpalo në mënyrë dramatike në pasqyrimin e masakrës në Zelandën e Re, në vitin 2019, në xhamitë në Christchurch, ku një terrorist i vetëm transmetoi drejtpërdrejt vrasjet që kreu, dhe njëkohësisht hodhi në internet një manifest të detajuar ku justifikonte vrasjet. Media u vu në pozitë të vështirë se çfarë të përdorte, duke patur parasysh që i gjithë materiali ishte përgatitur me kujdes që të përdorej me lehtësi nga mediat dhe përdoruesit e internetit.

Nga ana tjetër, edhe raportimi i ngjarjes pa publikimin e pamjeve, vetëm përmes spikerit apo reporterit, mund të ngjallë dyshime mbi vërtetësinë e raportimit, dhe mund të dështojë në përpjekjet për të rritur ndërgjegjësimin e publikut rreth akteve të tilla.

Të gjitha këto situata i vendosin në pozita të vështira redaktorët dhe gazetarët, prandaj është e dobishme hartimi i udhëzimeve të qarta se si duhet të reagojnë redaksitë e lajmeve, redaktorët dhe reporterët përballë akteve terroriste dhe shfaqjes së papritur të informacionit që vjen drejtpërdrejt nga terroristë që e njohin mirë mënyrën e funksionimit të medias.

Natyrisht që media nuk duhet të ndjekë kurrë shembullin e mediave sociale ose kanaleve video në internet që nuk janë të detyruara të respektojnë standarde profesionale, por informacione të këtij lloji nuk mund të injorohen, kështu që gazetarët dhe redaktorët duhet të jenë gjendje që të identifikojnë mënyra inovative raportimi që t'i ofrojnë

publikut informacionin e nevojshëm pa u bërë vegël e terroristëve për të shokuar njerëzit.

Botimi i pamjeve brutale të dhunës dhe vrasjes mund të justifikohet vetëm në raste shumë të rralla, por botimi i fotografive ose pamjeve statike që thjesht tregojnë kohën dhe vendin e ngjarjeve mund të jetë i përshtatshëm. Është e pamundur të përcaktohet paraprakisht se si duhet vepruar në çdo rast, por diskutimet dhe vendimet redaksionale mbi mënyrën se si duhet vepruar me ngjarje të tilla janë gjithmonë të dobishme, për të siguruar ndër të tjera, se nëse shfaqen imazhe dhe video që tregojnë skena të qarta të dhune, ky proces duhet të respektojë standardet redaksionale, duke e njoftuar paraprakisht publikun për imazhet që do të shfaqen, duke sinjalizuar përmbajtje të rëndë dhe shqetësuese.

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet rasteve kur imazhet përfshijnë fëmijë, pavarësisht nëse janë viktimat, të mbijetuar ose dëshmitarë. Mbrojtja e mirëqenies dhe identitetit të fëmijëve është një nga detyrimet kryesore etike dhe profesionale. Nga ana tjetër, duke pasur parasysh sa të pambrojtur janë fëmijët dhe sa ngarkesë emocionale mbartin, ata shpesh mund të bëhen imazhi që personifikon të gjitha viktimat e tjera ose personat që vuajnë nga terrorizmi apo katastrofat humanitare. Për shembull, fotografia e fëmijës sirian Alan Kurdi që dergjej i vdekur në një plazh në vitin 2015 u bë simbol i vuajtjeve të refugjatëve nga Siria dhe shkaktoi një reagim global.

Edhe pse botimi i kësaj fotografie u shoqërua me dilema etike, shumica e mediave vendosën ta botonin si një mënyrë për ta bërë më të prekshme tragjedinë e emigrimit, dhe për të ngjallur ndjeshmëri publike për kalvarin e refugjatëve që largohen nga zonat e konfliktit.

# 6

## Sfida dhe probleme gjatë raportimit të drejtpërdrejtë për terrorizmin

Gazetarët janë ndër personat e parë që shfaqen në skenën e një sulmi terrorist, dhe kjo i ngarkon ata me përgjegjësi të veçantë, pasi në momente emergjence dhe krize publiku i drejtohet emrave të njohur në media për të marrë informacion të besueshëm që mund t'i ndihmojë për të kuptuar çfarë po ndodh. Reporterët përballen me sfidën e sigurimit të informacioneve të sakta dhe të mirëfillta, ndërkohë që bëhen dëshmitarë të tragjedisë dhe vuajtjeve njerëzore.

Në këto raste është e rëndësishme që para se të nisin raportimin, gazetarët duhet të kujdesen për sigurinë e tyre dhe të njerëzve përreth. Raportimi gjatë situatave të rrezikshme shpesh kërkon akte heroizmi, dhe gazetarët nganjëherë janë të detyruar të rrezikojnë, por puna gazetareske në kushte të qeta dhe të sigurta është thelbësore për të arritur një raportim të mirë analitik.

Në raportime gjatë zhvillimit të akteve të dhunës, raportimi i drejtpërdrejtë i medias shpesh vonohet me disa sekonda, për të shmangur transmetimin e pamjeve tronditëse të dhunës, në

mënyrë që pamjet të analizohen nëse janë të përshtatshme për transmetim.<sup>7</sup>

Raportimi i drejtpërdrejtë paraqet një sërë sfidash e rreziqesh, pasi mund të krijojë probleme dhe të ndikojë në mënyrë negative në situata pengmarrjeje, çka kërkon kujdes të veçantë dhe bashkëpunim konstruktiv me autoritetet, për t'u siguruar që nuk do të shkaktohen shqetësime shtesë në lidhje me sigurinë dhe mirëqenien e personave, apo të vihen në rrezik operacionet e shpëtimit të jetës.

---

<sup>7</sup> Marthoz, 2017.

# 7

## Roli i mediave sociale

### ➤ **Media sociale ka transformuar rrënjësisht komunikimin**

Media sociale është një realitet i pamohueshëm që ka transformuar shoqërinë, duke bërë që shumë profesione dhe procese pune të ndryshojnë rrënjësisht.

Sipas Marshall McLuhan, kur një media e re bëhet pjesë e jetës dhe haset ngado rreth nesh, nuk jemi më në gjendje që të kuptojmë efektin transformues që ka mbi jetën tonë. Në momentet e para kur shoqëria fillon të përdorë një media të re, për njëfarë kohe jemi të vetëdijshëm për risinë e saj. Pas kësaj periudhe fillestare, ne thjesht zhytemi në këto media, dhe nuk jemi më në gjendje që të mbajmë njëfarë distance për të analizuar në mënyrë kritike zhvillimet dhe ndryshimet që këto media sjellin në botën tonë.

Që nga fillimi i viteve 2000 kur u shfaqën platformat e para, mediat sociale kanë depërtuar gjithnjë e më shumë në jetën tonë, duke ndryshuar mënyrën e komunikimit, mënyrën e ndërveprimit me njëri-tjetrin, si dhe angazhimin tonë në diskursin publik.

Ndikimi i mediave sociale në sektorin e medias dhe në gazetari ka qenë i madh dhe ka pasur një efekt transformues. Falë mundësive që ofrohen nga mediat sociale, gazetaria

e ditëve të sotme ka ngritur një sistem punë ku publiku bashkëpunon për prodhimin dhe shpërndarjen e lajmeve, duke i dhënë fund sistemit hierarkik tradicional të prodhimit të lajmit nga media. Gazetarët profesionistë nuk kanë më monopol mbi gjetjen, prodhimin dhe shpërndarjen e lajmeve. Redaksitë e lajmeve po shkojnë gjithnjë e më shumë drejt një marrëdhënieje bashkëprodhimi me audiencat. Rrjetet sociale si Facebook, Twitter, Instagram, por edhe aplikacionet e komunikimit si WhatsApp, janë bërë pjesë e “veglave të punës” të çdo gazetari.

Interneti ka krijuar një marrëdhënie të re, të drejtpërdrejtë midis publikut dhe lajmit, si dhe midis publikut dhe politikës. Ashtu siç ka thënë John Hall (2001), kemi hyrë në fazën e ndërmjetësimit masiv (Eugenia, 2018). Kjo përbën sfidën më të madhe për gazetarët në epokën e mediave sociale.

Në të njëjtën kohë, mediat sociale vënë në provë parimet e gazetarisë profesionale, duke përfshirë edhe standarde thelbësore siç janë verifikimi i fakteve dhe burimeve të informacionit. Informacioni dhe ngjarjet qarkullojnë së pari në mediat sociale, përpara se gazetarët dhe mediat të bëhen pjesë e këtij procesi, duke ngritur pikëpyetje serioze rreth të vërtetës dhe shtrembërimit të informacionit, si dhe duke shkaktuar konfuzion në publik në lidhje me atë çka është e besueshme e çka jo.

Informacioni mbi ngjarje terroriste që ndodhin në vende të ndryshme të botës fillimisht postohet nëpër rrjete sociale për audiencat e internetit. Media sociale e ka ndërlikuar edhe më shumë mbulimin dhe raportimin e ngjarjeve terroriste nga gazetarët profesionistë. Interesi i madh mbi lajmet rreth akteve terroriste bën që personat dëshmitarë nga vendi i të ngjarjes t'i raportojnë këto incidente në rrjetet sociale. Ndhimesa e qytetarëve, me foto dhe video në kohë reale nga terreni që publikohen rëndom në media sociale, shpesh

arrijnë të shpërqendrojë gazetarët profesionistë dhe vetë mediat. (Beckett, 2016)

Në raste të tilla është edhe më e nevojshme që të verifikohet informacioni për të mos rënë viktimë e “lajmeve të rreme” dhe dezinformimit. Gazetarët duhet të përvetësojnë njohuri dhe aftësi mbi përdorimin e teknikave të verifikimit të informacionit që qarkullon në mediat sociale.

Janë krijuar një sërë instrumentesh dhe teknikash për të ndihmuar gazetarët gjatë procesit të verifikimit, ashtu siç do të vërehet edhe më poshtë. Ka edhe grupe e organizata të reja për kontrollin e fakteve që synojnë të analizojnë mënyrat se si mund të shtrembërohet informacioni, ndërsa gazetarët mund të përdorin motorë kërkimi si Google, Yandex, Tin Eye, e të tjerë, për të gjetur dhe verifikuar origjinën e informacionit. Reporterët dhe redaktorët mund të përdorin këto instrumente teknologjike për të verifikuar imazhet e publikuara në mediat sociale, që më pas të përfshijnë në raportimet e tyre vetëm imazhet që nuk janë manipuluar.

Studimet tregojnë se mediat sociale amplifikojnë shkallën e komunikimit dhe ndikimin e terrorizmit. Organizatat ekstremiste dhe terroriste mund të komunikojnë drejtpërdrejt me audienca të gjera përmes mediave sociale, pa hasur në filtra editoriale dhe ndërmjetësim mediatik.

Elemente si anonimati, që është diçka e zakonshme në platformat e mediave sociale, e bëjnë më të lehtë përhapjen e propagandës ekstremiste dhe terroriste.

Ndonëse roli i mediave sociale në radikalizimin dhe ekstremizimin e individëve nuk është konfirmuar plotësisht nga të dhënat dhe studimet shkencore, mendohet se ato ndikojnë kryesisht përmes shpërndarjes së informacionit dhe propagandës, si dhe përmes angazhimit dhe identifikimit me një kategori të caktuar të audienës të interesuar në marrjen e mesazheve radikale dhe përmbajtjeve të dhunshme. (Alava, Frau-Meigs, & Hassan, 2017)

Të gjitha këto elemente nënvizojnë faktin se parimet thelbësore të etikës, transparencës dhe besueshmërisë luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në krijimin e respektit rreth gazetarisë, si një burim i besueshëm informacioni. Për këtë arsye, reporterët dhe gazetarët duhet të jenë shumë të kujdesshëm në gjuhën që përdorin në raportime, duke shmangur shprehjet përçmuese dhe duke mos përdorur terminologjinë e grupeve ekstremiste. Po kështu, është e rëndësishme që fotografitë ose pamjet filmike që shoqërojnë lajmet të vijnë nga burime të verifikueshme, duke shmangur kështu përdorimin e materialeve të postuara në mediat sociale ose faqe interneti që mund të promovojnë propagandë ekstremiste.

### ➤ **Dilemat etike që shoqërojnë raportimin për terrorizmin në mediat sociale**

Ashtu siç u përmend edhe në këtë udhëzues, gjatë raportimeve mbi terrorizmin gazetarët shpesh përballen me dilema etike dhe presion për t'iu përmbajtur parimeve profesionale. Këto vlera dhe parime vihen në provë gjithnjë e më shpesh në epokën e mediave sociale dhe mediat në internet. Testi kryesor është dilema se si të raportohet mbi terrorizmin pa u bërë vegël e terroristëve dhe pa mohuar aksesin e publikut në të gjitha informacionet e nevojshme, pasi informacioni i mangët rrezikon të krijojë një ndjenje të rreme sigurie. *“Raportimi i sulmeve terroriste në një farë mënyre përmbush objektivat e terroristëve për përhapjen e frikës, por nga ana tjetër, kufizimi i mbulimit shkakton humbjen e besimit të publikut ndaj medias.”* (Abubakar, 2020).

Gazetari i BBC-së Paul Wood, që ka raportuar gjerësisht mbi konfliktin në Siri, ka identifikuar një sërë dilemash me të cilat përballlet një gazetar që mbulon ngjarje terroriste. Duke



përmendur rastin e rrëmbimit të disa pengjeve nga ISIS, Wood ngre disa pyetje:

*“Çfarë roli duhet të luajë gazetari pasi bëhet dëshmitar i vdekjes brutale të një fëmije, - të bëjë raportim të paanshëm, apo të nxisë botën që të veprojë? Cilat imazhe janë të përshtatshme për transmetim pas një sulmi? Kur duhet mbajtur sekret informacioni për të shpëtuar jetën e atyre që mbahen peng? Si qëndron raporti ndërmjet ‘pastrimit’ të pamjeve të mizorive të luftës dhe transmetimit të imazheve që mund të inkurajojnë persona të tjerët që të bashkohen me ISIS?”<sup>8</sup>*

Padyshim që mediat sociale e rrisin mundësinë e dezinformimit në lidhje me raportimin mbi terrorizmin, dhe gazetarët shpesh bien pre e burimeve të paverifikuara, duke u bërë padashur vegla të grupeve terroriste. Martin Belam, një gazetar i Guardian që administronte disa prej llogarive zyrtare të gazetës në Twitter, thotë se raportimi i terrorizmit në mediat sociale është një sprovë e vazhdueshme.

Ai përmend një incident, ku një azilkërkuar nga Siria vrau me thikë një grua polake dhe plagosi dy të tjera. Ky ishte një nga katër sulmet terroriste të vitit 2016 që krijuan një klimë frike në Gjermani dhe çuan në shtimin e kritikave ndaj politikës së mikpritjes së emigrantëve nga Lindja e Mesme. Ditën që ndodhi sulmi, Belam publikoi lajmin në llogarinë e The Guardian në Twitter, duke e përshkruar këtë ngjarje si një aksident. Në një mesazh me 140 karaktere, aq sa lejon vetë platforma, ka pak mundësi për të dhënë detaje ose kontekstin në të cilin ndodh incidenti. Belam thotë se pas këtij postimi mori një sërë komentesh dhe kritikash nga

---

<sup>8</sup> Paul Wood; Pena dhe Shpata: Të raportosh mbi ISIS (The Pen and the Sword: Reporting ISIS),

<https://shorensteincenter.org/reporting-isis-paul-wood/>

përdoruesit e Twitter që e akuzonin për raportim të pasaktë të një ngjarjeje terroriste duke përdorur fjalën “aksident.”

Ai thotë:

*“Ndonjëherë e shtyp butonin për dërgimin e mesazhit me dhimbje në zemër, duke e ditur se thjesht postimi i titullit të një shkrimi do të shoqërohet me një valë kritikash. Ti mundohesh të përshkruash një ngjarje akoma të paqartë, sa më shkurt me një numër të kufizuar karakteresh, por e di mirë se çdo fjalë që zgjedh mund të paragjykohet nga një pjesë e audiencës. Dhe është e vështirë të raportosh me qetësi në këtë situatë.”*

### ➤ **Raportimi për terrorizmin pa i bërë jehonë propagandës terroriste**

Një tjetër dilemë që del para gazetarëve në epokën e mediave sociale është nëse duhet të publikohet emri i personit të përfshirë në një ngjarje terroriste, ose organizatës së përfshirë. Shumë punonjës të medias dhe gazetarë kanë pikëpamje të ndryshme mbi këtë çështje. Sulmet e vitit 2019 ndaj dy xhamive në Christchurch, Zelandë e Re, rezultuan në vrasjen e 51 personave. Ashtu siç u përmend më lart, autori i krimit transmetoi drejtpërdrejt sulmin nëpërmjet një kamere dhe faqes së tij në rrjetet sociale. Kjo ngjarje nderoi një debat të madh në mediat botërore në lidhje me përmendjen e emrit të autorëve të sulmeve gjatë raportimit. Debati nisi pasi kryeministria e Zelandës së Re refuzoi që të përmendte emrin e terroristit të përfshirë në atë sulm. Shumë media e ndoqën shembullin e saj.

Sidoqoftë, Katharine Viner, kryeredaktore e The Guardian, tha se lënia jashtë e emrit të autorit të sulmeve nuk pati efekt pozitiv mbi raportimin e fakteve. Në përgjigje të kritikave të lexuesve, ajo tha:

*“Roli i medias ndryshon nga roli i një politikani ose një partie politike; përgjegjësia jonë është të raportojmë faktet, t’i vendosim ngjarjet në kontekst, dhe të punojmë me lexuesit për të kuptuar se çfarë po ndodh. Mospublikimi i emrit të terroristit do të dëmtonte këto përpjekje.”*

Nga ana tjetër, një pjesë e mirë e mediave franceze reagoan ndryshe në lidhje me sulmin me kamion në rrugët e Nisës, në vitin 2016. Mediat vendosën të mos e përmendin emrin e terroristit kur raportuan për ngjarjen, duke u përpjekur të shmangin përçimin dhe amplifikimin e ideologjisë së organizatës përgjegjëse për sulmet. Për disa studiues dhe punonjës të medias, vendimi për të mos publikuar emrin e autorit ose organizatës gjatë raportimit të një ngjarjeje terroriste nuk mund të zbatohet në epokën e mediave sociale, megjithëse është e kuptueshme pse merret ky vendim nga media.

Në këtë pikë mund të vërehet qartë dallimi midis informacionit të publikuar në mënyrë të shkujdesur në mediat sociale, dhe profesionalizmit të bazuar në parimet gazetareske të mediave të lajmit, dhe shumë organe mediatike e pranojnë se mospublikimi i emrit, në një kohë kur informacioni për autorin dhe organizatën qarkullon në rrjetet sociale, dhe mund të gjenden lehtësisht nga çdokush, mund të shtojë mundësinë e përhapjes së teorive të konspiracionit nga të cilat mund të përfitojnë vetë ekstremistët.

Në këto rrethana, gazetarët që përballen me dilema të tilla mund të shqyrtojnë manualët dhe udhëzuesit profesionalë, manualët redaksionale të mediave ku punojnë, ose normat profesionale ndërkombëtare të përmbledhura në manuale të ndryshme. Atëherë kur mungojnë udhëzimet specifike dhe manualët, reporteri duhet të veprojë sipas ndërgjegjes së tij profesionale dhe parimit të interesit publik.

## ➤ **Verifikimi i fakteve, humanizmi, heroizmi dhe gazetaria analitike**

Në epokën e rrjeteve sociale, gazetaria vazhdon të ketë për detyrë verifikimin e fakteve dhe të raportojë në mënyrë profesionale, duke përfshirë edhe shpjegimin e kontekstit dhe arsyeve për një akt terrorist. Është akoma shumë e rëndësishme që gazetarët të tregojnë vetëpërbajtje dhe profesionalizëm kur raportojnë mbi ngjarje terroriste, edhe përballë zhurmës dhe zemëratës që krijohet në mediat sociale dhe rrjedhat e informacionit në internet. Ata duhet të vrasin mendjen dhe të tregohen të kujdesshëm para se të botojnë përmbajtje shqetësuese, veçanërisht në rastet e imazheve të qarta të dhunës ose vuajtjeve njerëzore (White, 2019).

Duke punuar në mënyrë profesionale dhe me përgjegjshmëri, gazetarët mund të pengojnë përhapjen dhe promovimin e axhendës politike të personave përgjegjës për sulmet. Gazetarët që raportojnë mbi këto ngjarje, si duke përdorur mediat sociale ashtu dhe instrumentet tradicionale të raportimit, duhet të nxjerrin në pah anën njerëzore të viktimave dhe heroizmin e individëve të guximshëm që rrezikojnë jetën e tyre për të ndihmuar të tjerët.

Heronjtë e raportimeve në media mund të jenë një shofer taksie që transporton persona të plagosur në spital, ose një infermiere që mjekon plagët e viktimave. Duke vepruar në këtë mënyrë, gazetarët mund të neutralizojnë strategjinë e terroristëve, duke u përqendruar në vlerat njerëzore të solidaritetit dhe dashamirësisë që i afrojnë njerëzit me njëri-tjetrin. Për ta bërë këtë në mënyrë të efektshme, mediat duhet të mbajnë parasysh një nga rekomandimet kryesore të konferencës së OSBE të organizuar në shtator 2018, në Sarajevë, e cila u bëri thirrje mediave “të kalojnë nga një formë e gazetarisë pasqyruese në një gazetari reflektuese.”

## ➤ Ruajtja e pavarësisë në raportim

Mediat sociale paraqesin një problem shtesë për organet e medias, pasi nganjëherë kemi të bëjmë me një mori burimesh. Rrjetet sociale krijojnë një mjedis ku grupe të shumta bashkëveprojnë, duke qenë njëkohësisht konsumatorë dhe prodhues të informacionit. Nga ky këndvështrim, gazetarët ndonjëherë ndihen të vënë nën presion për të raportuar pa marrë parasysh burime alternative informacioni që mund të jenë të interesuar të përfshihen në pasqyrimin e ngjarjes.

Sa autonomi profesionale gëzojnë gazetarët gjatë raportimit të konflikteve dhe sulmeve terroriste? Deri në çfarë mase mund të bien nën kontrollin e elementëve të tillë si shtete dhe grupe terroriste, apo edhe të vetë audiencës? (Brosse & Holt, 2019). Këto pyetje i shoqërojnë vazhdimisht reporterët gjatë mbulimit dhe raportimit të akteve terroriste.

Për t'i bërë ballë një morie opinionesh dhe interesash personale, gazetarët duhet të tregohen të kujdesshëm dhe të mbajnë një qëndrim objektiv, duke e mbrojtur veten nga presioni emocional. Ndikimi emocional i ngjarjeve terroriste mbi audiencat shpesh gjeneron një presion që mund të vërë në provë pavarësinë e raportimit gazetaresk.

Kur kemi të bëjmë me ngjarje të dhunshme, audiencat reagojnë emocionalisht dhe ky reagim është edhe më i pranishëm në mediat sociale, ku individë të ndryshëm kanë më shumë mundësi të shprehin zemëratën e tyre për ngjarjet me një gjuhë të ashpër, madje dhe të egër. Ky reagim infektion të tjerët në mënyrë virale përmes ndërveprimit të përdoruesve të rrjetit social, duke qenë se edhe logjika e algoritmeve të rrjeteve sociale favorizojnë shpërndarjen e përmbajtjes në grupe të caktuara njerëzish që mendojnë në mënyrë të ngjashme, dhe kjo gjeneron akoma më shumë ndërveprim.

Klima e krijuar nga përhapja virale e reagimeve emocionale të audiencës, paralelisht me qëndrimin e institucioneve qeveritare që kërkojnë një qëndrim të unifikuar kundër organizatave terroriste, mund të pengojë përpjekjet e gazetarëve për të mbajtur distancën e nevojshme profesionale në raportim.

Në raste të tilla, gazetarët mund të lënë jashtë vëmendjes përgjegjësinë e autoriteteve ndërkohë që përqendrohen mbi pasojat e akteve terroriste. Në emër të një “qëndrimi të përbashkët” ndaj terrorizmit, gazetarët rrezikojnë të kthehen në vegla të pushtetit. Ata duhet t'i qëndrojnë gjithmonë besnikë misionit të kërkimit të së vërtetës.

### ➤ **Lajmet e rreme, mediat sociale dhe raportimi për terrorizmin**

Ndonëse diskutimet në lidhje me lajmet e rreme shpesh përqendrohen në ndikimin e dezinformimit në fushën e politikës, diplomacisë, medias dhe ekonomisë, është e rëndësishme të theksohet se “lajmet e rreme” apo dezinformimi është një fenomen që ka lulëzuar kryesisht nga përhapja dhe popullariteti në rritje i mediave sociale. Gazetarët që raportojnë mbi terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm përballen me sfidën e përhapjes së lajmeve të rreme si pasojë e zhvillimeve teknologjike të mediave sociale.

Një studim i Institutit Reuters për Studimin e Gazetarisë me mediat në Itali dhe Francë hodhi dritë mbi përhapjen e “lajmeve të rreme” dhe dezinformimit në internet në hapësirën informative evropiane. Studimi zbuloi se aksesimi i audiencës në portalet që përhapin lajme të rreme është në nivele të papërfillshme në krahasim me numrin e vizitorëve në faqet e lajmeve të mediave të njohura si *Le Figaro* në Francë dhe *La Repubblica* në Itali. Niveli mesatar mujor i vizitorëve në një faqe që publikon lajme të rreme nuk e kaloi nivelin 3,5

për qind në vitin 2017, një shifër që korrespondon me më pak se 1 për qind të përdoruesve të internetit në Francë dhe Itali. (Fletcher, Cornia, Graves, & Nielsen, 2018)

Nga ana tjetër, analiza e të dhënave për përdoruesit e internetit në këto dy vende tregoi se pavarësisht nga numri i ulët i përdoruesve dhe kohës së shkurtër që kalohet në faqet e lajmeve të rreme, në krahasim me burimet serioze të lajmeve në internet, shkalla e ndërveprimit që gjenerojnë faqet e lajmeve të rreme në Facebook është në një nivel shumë të lartë. Kjo tregon edhe një herë rolin që luajnë mediat sociale në përhapjen e lajmeve të rreme.

Autorët e studimit ndoqën një metodologji të bazuar në analizën e të dhënave të mbledhura nga dy platforma ndërkombëtare në internet *comScore* dhe *CrowdTangle*, për 300 faqe lajmesh në Francë dhe Itali. ComScore jep të dhëna analitike mbi nivelin e përdorimit të faqeve kryesore në vende të ndryshme, ndërsa *CrowdTangle* është një instrument që mbledh të dhëna mbi aktivitetin e faqeve të caktuara në Facebook.

Pra, ndonëse faqet e mediave sociale që përhapin informacione të rreme nuk përdoren shpesh dhe nuk preferohen nga përdoruesit e internetit që kërkojnë lajme mbi ngjarje terroriste, ato kryejnë rolin e “përhapësve në masë” të dezinformimit, dhe gazetarët duhet të zgjerojnë diapazonin e njohurive të tyre në lidhje me këtë fenomen, ndërkohë që i qëndrojnë besnikë parimeve themelore të profesionit të tyre, si verifikimi i fakteve dhe burimeve të informacionit.

### ➤ **Disa instrumente dhe teknika për të verifikuar informacionin në mediat sociale**

Në ditët e sotme, gazetarët kanë në dispozicion instrumente të ndryshme për t'i ndihmuar në verifikimin e informacionit të publikuar në mediat sociale. Ekzistojnë një

numër platformash dhe aplikacionesh në internet (që mund të përdoren nga të gjithë) për verifikimin e fotografive, videove, profileve ose faqeve në Facebook, Twitter, Instagram, etj.

### **InVID**

Ky është një nga aplikacionet më të përdorura nga gazetarët. Nëpërmjet këtij aplikacioni, që mund t'i bashkëngjitet programit të aksesit në internet (browser), mund të verifikohen imazhe, video dhe materiale të tjera të botuara në mediat sociale. Aplikacioni analizon materialet duke kërkuar të drejtat e autorit, burimin origjinal, si dhe elemente të tjera që ndihmojnë gazetarin në verifikimin e fakteve.

### **Tineye**

Tineye është një tjetër aplikacion që ndihmon në identifikimin e imazheve të manipuluar. Disa nga profilet dhe faqet e organizatave terroriste në mediat sociale përdorin teknologjinë në mënyrë të sofistikuar për të manipuluar pamje dhe video, që më pas publikohen duke mashtruar publikun e gjerë dhe përdoruesit e rrjeteve sociale. Edhe gazetarët dhe mediat shpesh bien pre e këtyre materialeve të manipuluar që mund t'i serviren publikut si lajme autentike. Tineye ndihmon gazetarët që të identifikojnë një imazh të manipuluar, ose një imazh të marrë jashtë kontekstit.

### **Twitonomy**

Twitonomy është një instrument për të analizuar dhe verifikuar llogaritë në Twitter dhe përmbajtjen e publikuar në to. Ky instrument i ndihmon gazetarët që të identifikojnë sjelljen e dyshimtë të disa llogarive në Twitter. Në disa raste, llogari të ndryshme në platformën Twitter funksionojnë në formën e "robotëve," duke postuar materiale në mënyrë



të automatizuar përmes programeve kompjuterikë ose algoritmeve të caktuar. Teknika të tilla shpesh përdoren nga grupe të ndryshme për të përhapur mesazhe denigruese kundër një individi, komuniteti, grupi fetar, etj. Nëpërmjet Twitonomy, gazetarët mund të verifikojnë ritmin e postimeve dhe elementë të tjerë të aktivitetit të profileve në platformën Twitter.

# 8

## Shmangia e gjuhës së urrejtjes

Gjuha e urrejtjes është abuzimi më i rëndë me lirinë e shprehjes. Mund t'i nxisë njerëzit që të ndër marrin akte dhune, dhe të dëmtojë bazat e respektit për të drejtat, pluralizmin kulturor dhe tolerancën. Në epokën e teknologjisë së informacionit, gjuha e urrejtjes në internet përhapet me shpejtësi, duke përfshirë edhe mediat online. Gjuha e urrejtjes shkakton dëm të madh, por gazetarët mund të luajnë një rol të rëndësishëm në vënien nën kontroll dhe kufizimin e përhapjes së saj.

Gjatë viteve të fundit, në Shqipëri ka patur përpjekje dhe nisma për të rregulluar me ligj gjuhën e urrejtjes, lajmet e rreme dhe dezinformimin, veçanërisht në lidhje me portalet online, që janë hapësira më e favorshme për shprehjen, nxitjen dhe përhapjen e këtyre fenomeneve shqetësuese.

Por çfarë nënkuptohet saktësisht me gjuhën e urrejtjes? Gjuha e urrejtjes nuk ka një përkufizim të vetëm të qartë, sepse është një koncept emocional, por në këtë udhëzues, ne i referohemi përkufizimit të përpiluar nga organizata për mbrojtjen e lirisë së fjalës Article 19, i cili e konsideron gjuhën e urrejtjes si:

*“Çdo shprehje e urrejtjes diskriminuese ndaj njerëzve të tjerë: edhe kur nuk shkaktojnë ndonjë pasojë të veçantë. E thënë thjesht, ‘gjuha e urrejtjes’ vë në shënjestër njerëz,*

*si individë ose grupe, për shkak të asaj që janë. Mund të paraqitet në forma të shumta: me shkrim, joverbale, vizuale, artistike, etj, dhe mund të përhapet përmes çdo media, duke përfshirë internetin, shtypin, radion ose televizionin.”<sup>9</sup>*

Duke qenë se gazetarët janë në gjendje të ushtrojnë ndikim mbi një audiencë të gjerë, dhe të mbulojnë fusha të shumta me interes publik duke përfshirë politikën, çështje sociale, kulturore dhe ekonomike, ata kanë një përgjegjësi të veçantë që të evitojnë përhapjen e gjuhës së urrejtjes në çfarëdo platforme informacioni që përdorin, audiovizive, media e shkruar ose online.<sup>10</sup>

Nevoja për të treguar kujdes në raportimin e lajmeve u vu në pah në rastin e raportimit mbi shqiptarët e përfshirë në luftën në Irak, ku vetë gazetarët nuk përdorën shprehje të gjuhës së urrejtjes, por përçuan deklarata që përmbanin gjuhë urrejtjeje.

Lajmi kishte të bënte me rastin e dy personave që pretendonin se ishin hoxhallarëve, dhe në gazetatat shqiptare u botuan një sërë artikujsh me tituj pak a shumë të ngjashëm: “Rrjeti i rekrutimit, hoxhallarët e vetëshpallur.” Duke cituar të dhëna nga prokuroria, shtypi i portretizoi këta persona si teologë radikalë që predikonin Islamizmin e dhunshëm, nxisnin urrejtjen kundër besimtarëve jomyslimanë dhe besimeve të tjera, nxisnin frymën e përçarjes brenda komunitetit mysliman, ideuan dhe koordinuan rekrutimin, organizimin dhe transportimin e besimtarëve myslimanë shqiptarë për të luftuar në emër të xhihadit në Siri.

---

<sup>9</sup> Article 19 (2015) Shpjegimi i gjuhës së urrejtjes. Instrumente të nevojshme (Hate Speech explained. A toolkit) <https://www.article19.org/resources/hate-speech-explained-a-toolkit/>

<sup>10</sup> Mihajlllova, Elena, Jasna Bačovska, dhe Tome Shekerxhiev (2013). Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtjes. Shkup: Polyesterday.

Megjithëse dhanë informacion në lidhje me veprimtarinë e këtyre hoxhallarëve, të cilët “kishin praktikuar për gjashtë vjet me radhë veprimtari fetare të paligjshme,” asnjë nga gazetarët nuk u interesua të pyeste se përse ishin lënë të punonin ilegalisht për kaq shumë kohë, ndonëse autoritetet shtetërore duket se ishin të dijani të këtij informacioni.<sup>11</sup>

Prania e gjuhës së urrejtjes, e shprehur në formë të hapur ose të fshehtë, është e dëmshme në të gjithë spektrin e informacionit publik, dhe ky problem është shumë i vështirë të zgjidhet. Gjuha e urrejtjes shfaqet kryesisht në portalet online dhe mediat sociale pas sulmeve terroriste, por kërkimi i llogarisë ndaj mediave për praninë e kësaj gjuhë në faqet e tyre është një çështje e komplikuar. Mediat nuk mundën që thjesht t’i injorojnë komentet e dëgjuara nga publiku, apo t’i bllokojnë ato tërësisht, dhe në fund të fundit as kjo nuk e ndalon dot përhapjen e informacionit dhe gjuhës së urrejtjes. Kjo formë censure është kundërproduktive, por edhe në rast se ushtrohet ky kontroll, kjo heshtje artificiale nuk mund t’i rezistojë presionit të rrjeteve sociale për një kohë të gjatë.<sup>12</sup>

Në vend që të zbatohet kjo lloj ndërhyrjeje, duhet të zbrërthjëm dhe të analizojmë arsyet dhe motivet që e shkaktojnë gjuhën e urrejtjes. Kjo përjasje mund të jetë më produktive, edhe pse kërkon më shumë kohë dhe burime.

Gjithashtu, duhet të kemi parasysh se gjuha e urrejtjes shpesh publikohet për arsye komerciale dhe për të tërhequr sa më shumë klikime. Në lidhje me këtë problem, sektori i medias duhet të gjejë një gjuhë të përbashkët, dhe të aplikojë masa apo

---

<sup>11</sup> Skura, G. (2015) Media online dhe “gjuha e urrejtjes”. Marrë nga <http://www.respublica.al/content/media-online-dhe-%E2%80%9Cgjuha-e-urrejtjes%E2%80%9D>. Vizituar më 13.05.2020, ora 10:30

<sup>12</sup> UNESCO (2017) Terrorizmi dhe Media. Manual për gazetarët (*Terrorism and the Media. A handbook for Journalists*). UNSECO, faqe 67

kundërpërgjigje për këto raste, edhe pse modeli i biznesit të mediave në internet nuk lë shumë hapësira në këtë drejtim për momentin.

Si përfundim, është më mirë që t'i kundërviheni mesazheve të urrejtjes përmes promovimit të gazetarisë etike dhe profesionale që përçon informacion të besueshëm dhe të saktë. Forcimi i besimit të publikut ndaj gazetarisë jo vetëm që do të luftojë injorancën dhe frikën e shkaktuar nga terrorizmi dhe dezinformimi i mediave sociale, por do të ndihmojë audiencat që ta njohin më mirë botën përreth tyre, dhe të eksplorojnë botën e re të informacionit me besim dhe siguri.

## **Disa materiale të dobishme për gazetarët që raportojnë mbi terrorizmin**

**Udhëzime të BBC** për raportimin mbi krizat dhe emergjencat (BBC Guidelines on reporting crises and emergencies)  
<https://www.bbc.com/editorialguidelines/guidelines/war-terror-emergencies/guidelines>

**Qendra Dart për Gazetari dhe Trauma:** Raportimi i Terrorizmit (Dart Centre for Journalism and Trauma: Reporting Terrorism)  
<https://www.mediasupport.org/blogpost/the-right-to-know-and-the-duty-to-protect-terrorism-and-the-media/>

**Udhëzimet e OSBE-së** për Gazetarët që raportojnë për ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin (OSCE Guidelines for Journalists reporting on violent extremism and terrorism)  
<https://www.osce.org/files/f/documents/9/2/442381.pdf>

**Terrorizmi dhe Media:** Një udhëzues i UNESCO-s për gazetarët (Terrorism and Media: A UNESCO guide for Journalists)  
<https://en.unesco.org/news/terrorism-and-media-handbook-journalists>

**Manuali i Verifikimit:** Udhëzues për raportimin e emergjencave në media (Verification Handbook: Guide for emergency media coverage)  
<http://verificationhandbook.com/>

**Media Kundër Urrejtjes:** Video e Rrjetit të Gazetarisë Etike - testi me pesë pika për gjuhën e urrejtjes (Media Against Hate: Video of Ethical Journalism Network 5-point test for hate speech)

<http://europeanjournalists.org/mediaagainsthate/ejn-5-point-test-for-hate-speech-available-in-17-languages/>  
<https://ethicaljournalismnetwork.org/hate-speech>

**Raporti i EJN për gazetarinë në epokën pas së vërtetës: Udhëzime për burimet** (EJN Report Journalism in the Post-Truth Era: Guidelines for Sources)

<https://www.researchgate.net/publication/317411801>

**Komiteti i Rajoneve të BE-së:** Prezantimi Gjuha e Urrejtjes dhe etika e gazetarisë (EU Committee of the Regions: Presentation Hate Speech and journalism ethics)

[https://cor.europa.eu/en/events/Documents/Europcom/T%20Law\\_Session%2014.pdf#search=hate%20speech%20journalism](https://cor.europa.eu/en/events/Documents/Europcom/T%20Law_Session%2014.pdf#search=hate%20speech%20journalism)

**Mbështetje Ndërkombëtare për Median:** Si të raportohet për terrorizmin (International Media Support: How to Report Terrorism)

<https://www.mediasupport.org/blogpost/the-right-to-know-and-the-duty-to-protect-terrorism-and-the-media/>